



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primenë: 22-05 2012

| Nr. i organit Org. broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
|----------------------------|------------|-------------------|-------------------|
| 01 | 013/639 | | |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovë, nenit 35.2. shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2012 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS SË VITISË QË TË KETË TË DREJTËN E KËMBIMIT TË PRONËS KOMUNALE ME ATË SHOQËRORE TË MENAXHUARA NGA AGJENSIONI KOSOVAR I PRIVATIZIMIT

Neni 1

Me këtë vendimi, **SHFUQIZOHET** Autorizimi i Kryetarit të Komunës së Vitisë që të ketë të drejtën e këmbimit të pronës komunale me atë shoqërore të menaxhuar nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP) numër 01- 07-801 të datës 09.06.2011.

Neni 2

Shfuqizimi i autorizimit nga neni 1 i këtij vendimi bëhet për shkak të pengesave ligjore lidhur me zbatueshmërinë e autorizimit të Kryetarit të Komunës së Vitisë që të ketë të drejtën e këmbimit të pronës komunale me atë shoqërore të menaxhuara nga AKP-ja dhe i njëjti bie ndesh me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Vitisë dhe si i tillë de facto dhe de jure është inekzistent.

Neni 3

Me shfuqizimin e autorizimit të kryetarit të Komunës së Vitisë që të ketë të drejtën e këmbimit të pronës komunale me atë shoqërore të menaxhuar nga AKP-ja, Autorizimi numër 01-07-801 i datës 09.06.2011 pushon të prodhon efekte juridike.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

01 Nr _____
Viti, 17 maj 2012

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Skenderbe Hebibi

